



Goran Maksimovic
Pronar
Radio Hit Laser
R040
Pasjane

VENDIM: LIC/KPM-2013/

Ref:xxxx/xxxx/KPM/xx

1302/376/KPM/n.i.

VENDIM

lidhur me ndryshimin e pronësisë së Radio HIT LASER-Pasjan

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio HIT LASER është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në Pasjan Radio HIT LASER është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit me datën 6 tetor 2009.
3. Me datën 10 janar 2012, Radio HIT LASER përmes TV Pulsit ka dorëzuar ne zyrën e KPM-së, një kërkesë për ndryshimin e pronësisë së radio stacionit si dhe ndryshimin e lokacionit të transmetimit duke kaluar ne Majën e Gjelbwrt në shtyllen e transmetimit të TV Pulsit.
4. Me anë të një deklaratë, si pjesë e kërkesës për ndryshimin e pronësisë të Radio HIT LASER, pronari aktual, z. Goran Maksimovic, ka deklaruar se për shkaqe financiare pajtohet që pronësinë të'a kaloj TV Puls. Prandaj, ai ka kërkuar nga KPM, që ti lejoj transferimin e pronësisë të TV Puls me pronar z. Nenad Milenkovic.
5. Poashtu z. Nenad Milenkovic, ka kërkuar nga KPM që ta mundësojë transferimin e pronësisë së Radio HIT LASER në emër të tije dhe se është i gatshëm të punojë në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e KPM-së.

Arsyetimi

6. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”.


8. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”.*
9. Neni 5.2 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *I licencuari nuk mund të transferojë ose dorëzojë këtë licencë ose frekuenc-ën(at) e përcaktuara të saj pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së. Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 49% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht autorizim me shkrim nga ana e KPM-së.*
10. Neni 5.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë.*
11. Prandaj, në pajtim me nenin 5.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se kandidatit të propozuar për pronar t'i transferohet licenca, i përmbush standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.
12. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik për të aprovuar kërkesën për bartje të pronësisë.

Vendim

13. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio HIT LASER nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit dhe zonës së mbulimit.
14. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se kandidati për pronarë të ri të Radio HIT LASER ka njohuri profesionale në drejtimin e radio stacionit, pasi që i njëjti ka punuar për një kohë të gjatë në këtë subjekt transmetues.
15. Komisioni i Pavarur për Media, vendos që pronësia e Radio HIT LASER të transferohet te TV Puls dhe licenca e Radio HIT LASER të ndryshohet.
16. Ndërsa, kërkesa për ndryshimin e lokacionit të transmetimit të Radio HIT LASER, nga lokacioni i licencuar në Pasjan për të kaluar në Majën e Gjelbërt në shtyllën e transmetimit të TV Pulsit, nuk miratohet dhe se vendndodhja e transmetuesit të Radio HIT LASER mbetet e njëjta ashtu siç figuron në licencën afatgjate, deri në një vendim të ardhshëm të Komisionit.

Lëshimi i vendimit

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



15.02.2013
datë